URDHËR
Nr. 1030, datë 2.9.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Kompetencat e deleguara nga ministri tek sekretari i përgjithshëm, delegohen tek z. Sokol Ismaili, drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, për periudhën 3.9.2025 deri më 10.9.2025.
2. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Sokol Ismaili, për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për komunikimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS
DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja